

VENDIM
Nr. 396, datë 19.6.2019

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 16.2.2017, PËR ÇËSHTJEN “CAKA KUNDËR SHQIPËRISË” (KËRKESA NR. 74941/14)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.2.2017, për çështjen “Caka kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 74941/14, për shumën 10 400 (dhjetë mijë e katërqind) euro, për kërkuuesen Kleopatra Caka, në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror, si dhe kostot e shpenzimet, duke e përjashtuar nga çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkueses Kleopatra Caka, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.2.2017, për çështjen “Caka kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 74941/14.

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3, të këtij vendimi, në favor të kërkueses Kleopatra Caka, të bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit.

5. Mbi shumën e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, duke filluar nga data 16.5.2017, deri në datën e ekzekutimit të këtij vendimi, të paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe